

2024



BAROMETRI I SIGURISË SHQIPËRI ANKETË KOMBËTARE

CSDG

Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

Barometri i Sigurisë Shqipëri

Anketë Kombëtare 2024

Autorë

Arjan Dyrmishi
Mirsada Hallunaj
Nino Strati

Metodologjist

Eduard Zaloshnja

Përpunimi i të dhënave

Alaattin OZDE, Albelite Design

Parathënie

Stine Klapper, Përfaqësuese Rezidente, Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra Tiranë

Imazhet

Freepik.com

Dizajni Grafik

Ergys Temali

Intervistat në terren

Agnie Konomi, Anila Gjini, Ariola Mulaj, Arjana Kola, Behie Alushi, Besiana Paftali, Caush Idrizi, Clirim Shehu, Denisa Elezi, Diana Minarolli, Etvald Rama, Elida Balla, Elma Saraci, Endri Habip, Eneida Sokolli, Irena Dervishi, Irena Llambi, Irma Coku, Joana Meco, Jorida Haznedari, Leonora Celaj, Liljana Gjinali, Lindita Pirani, Mirjana Beqiraj, Matilda Zeneli, Qazim Palushi, Rajmonda Nushi, Sami Mecollari, Shpresa Faria, Silva Shupo, Sofije Qoshku, Sonila Prushi, Vjollca Gjini, Vjollca Duka.

Mirënjohtë

Ky edicion i Barometrit të Sigurisë Shqipëri, u bë i mundur me mbështetjen e Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra Tiranë.

E drejta e autorit

© Të gjithë të drejtat janë të rezervuara për Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) dhe Friedrich Ebert Stiftung. Asnjë pjesë e këtij studimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem për ruajtje të dhënash, ose të transmetohet, në mënyrë, elektronike, mekanike apo me çfarëdo forme tjetër, pa cituar Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG).

CSDG dhe FES, Qershor 2024

Parakusht

Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Friedrich -Ebert -Stiftung (FES). Analizat e prezantuara në këtë raport reflektojnë vetëm perceptimet e qytetarëve dhe nuk përbëjnë në asnjë mënyrë një vlerësim përfundimtar mbi çështjet e trajtuara.

Përmbajtja

Lista e shkurtimeve	6
Parathënie	7
Hyrje	9
Metodologjia	11
Gjetjet kryesore	13
Kërcënimet e sigurisë dhe marrëdhëniet me vendet e tjera	29
Siguria politike	37
Siguria ekonomike	46
Siguria ushqimore	62
Siguria shëndetësore	66
Maskuliniteti dhe siguria gjinore	73
Anëtarësimi në BE	81
Vlerësimi i performancës së qeverisë dhe gjyqësorit	84
Shtojca 1: Harta e shpërndarjes gjeografike të kampionit	90
Shtojca 2: Shpërndarja e kampionit në 61 bashkitë	91
Shtojca 3: Pyetësi i anketës	93

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi Evropian
CSDG	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara
FES	Friedrich-Ebert-Stiftung
SPAK	Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
UN	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Parathënie

Bota jonë ka ndryshuar që nga botimi i parë i Barometrit Shqiptar të Sigurisë (BSHS) në vitin 2019. Ngjarje të përmasave të ndryshme kanë tronditur rendin global dhe perceptimin tonë për sigurinë: pandemia e Covid-19, sulmi rus në Ukrainë, sulmet kibernetike kundër Shqipërisë, përshkallëzimet serbe kundër Kosovës, lufta në Lindjen e Mesme – ne jetojmë në një mjedis ndërkombëtar me armiqësor me potencialin e rritjes së ndikimit të fuqive politike autoritare të ekstremist të djathtë. Politika e sigurisë ka marrë për pasojë një përparësi më të lartë në agjendat politike dhe në diskutimet publike dhe private në shumë vende.

Këto zhvillime janë pasqyruar në anketën që përbën bazën e këtij raporti. Megjithatë, është e rëndësishme, që si në botimin e mëparshëm, ky edicion i BSHS-së përfshin më shumë sesa pyetje mbi sigurinë shtetërore dhe kërcënimet e jashtme. Elementë të rëndësishëm të konceptit shumë më të gjerë të sigurisë njerëzore, si siguria politike, ekonomike, ushqimore, shëndetësore dhe personale janë analizuar gjithashtu. Këto janë të lidhura me mjedisin ndërkombëtar të sigurisë, por janë edhe më të rëndësishme për sa i përket ndikimit të tyre në jetën e përditshme të qytetarëve. Prandaj, zbatimi i këtij koncepti të sigurisë njerëzore mund të nxisë një diskutim shumë më të gjerë mbi zhvillimin e politikave dhe angazhimin e shoqërisë civile. Po aq e rëndësishme është që kjo anketë jep një pasqyrë të perceptimeve të qytetarëve mbi kërcënimet e sigurisë dhe mbi ofrimin e sigurisë si një funksion themelor i shtetit. Kjo është e rëndësishme sepse nuk mjafton thjesht të ekzaminohen statistikat mbi incidentet e lidhura me sigurinë kur zhvillohen opsionet politike. Qytetarët duhet të ndihen të sigurt, në dimensionet e ndryshme të sigurisë njerëzore, në mënyrë që të kenë besim tek shteti dhe institucionet e tij, proceset demokratike dhe tek njëri-tjetri.

Shumë gjetje tregojnë çështje strukturore të krahasueshme ndër vite. Korrupsioni është perceptuar si kërcënim më serioz për sigurinë në çdo edicion të Barometrit Shqiptar të Sigurisë. Prandaj, nuk është befasuese që besimi në institucionet demokratike dhe elitën politike mbetet i ulët dhe qytetarët besojnë se pronarët e bizneseve të mëdha ndikojnë shumë në qeveri. Megjithatë, shumica beson se Shqipëria po ecën në drejtimin e duhur dhe gjithashtu beson se njësisia e prokurorisë anti-korrupsion SPAK është serioze në luftën e saj kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ky rezultat është i rëndësishëm për të gjithë vendimmarrësit dhe mund të lexohet si një nxitje për të vazhduar në këtë rrugë. Pa asnjë dyshim, të anketuarit duan që kjo rrugë të çojë drejt anëtarësimit në BE. Të gjitha këto përgjigje duhet të merren parasysh nga partnerët evropianë, mbështetja dhe bashkëpunimi i të cilëve janë thelbësore.

Një grup tjetër interesant gjetjesh lidhet me maskulinitetin ose mbizotërimin e normave sociale, të cilat i atribuojnë gjinive të ndryshme një grup të caktuar sjelljesh të supozuara si të duhurat. Në shumë vende, këto norma gjinore dhe sjellje të pritshme kanë krijuar tradicionalisht një mjedis të politikave dhe praktikave të sigurisë të dominuara nga ajo që është konsideruar si mashkullore – si tek aktorët ashtu edhe në veprimet e tyre. Të gjitha përshkallëzimet e

dhunshme që shohim globalisht sot mund të lidhen me hegjemoninë e maskulinitetit të shprehur në fenomene të tilla si lufta për dominim, militarizimi dhe kontrolli. Ky pozicion hegjemonik mund të shihet gjithashtu në përgjigjet e dhëna në këtë anketë, edhe pse jo në të gjitha aspektet. Ndërsa disa gjetje janë shumë inkurajuese (pothuajse të gjithë të anketuarit duan të shohin gra në pozita politike), të tjera ende tregojnë pritshmëri gjinore ("burrat e vërtetë nuk duhet të shprehin emocione"). Është e rëndësishme të theksohet se, meqenëse këto pritshmëri janë konstruksione shoqërore, ato shpeshherë shprehen njësoj nga burrat dhe gratë, megjithëse në shkallë të ndryshme. Në përgjigje të këtyre fenomeneve, një politikë e sigurisë feministe ofron opsione përtej militarizimit dhe politikës së fuqisë. Këto opsione të politikës feministe janë të rëndësishme si për sigurinë e brendshme ashtu edhe për atë ndërkombëtare, duke synuar një siguri dhe paqe më bashkëpunuese dhe të qëndrueshme për të gjithë. Ne besojmë se përgjigjet e dhëna në këtë anketë ofrojnë njohuri të rëndësishme për diskutimet e ardhshme mbi këto shkaqe të pasigurisë të lidhura me maskulinitetin dhe mbi ndërhyrjet e mundshme.

Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra në Tiranë, sheh një kontribut të rëndësishëm në këtë botim të ri të BSHS-së, pasi është sërish i pasur me njohuri që lidhen me sigurinë njerëzore në Shqipëri. Shpresojmë se do të informojë debatet e ardhshme nga palët e interesuara nga shoqëria civile dhe akademja, si dhe përfaqësuesit politikë, dhe do të ndihmojë në zhvillimin e politikave që ofrojnë siguri të qëndrueshme në këto kohë të trazuara. Falënderojmë dhe urojmë Arjan Dyrmishin dhe ekipin e tij në Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes për punën e tyre të rëndësishme dhe të jashtëzakonshme.

Stine Klapper

Përfaqësuese Rezidente

Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra Tiranë

Hyrje

Që prej vitit 2019 Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes ka publikuar Barometrin e Sigurisë, një anketë kombëtare për sigurinë, e cila mat qëndrimet, opinionet dhe perceptimet e qytetarit shqiptar për aspekte të ndryshme të sigurisë.

Analiza e Barometrit të Sigurisë ndjek qasjen e reformës në sektorin e sigurisë, e cila përkufizohet si një proces politik dhe teknik i përmirësimit të sigurisë shtetërore dhe njerëzore duke zbatuar parimet e qeverisjes së mirë në sektorin e sigurisë.¹ Bazuar në këtë qasje, Barometri i Sigurisë eksploron ofrimin e sigurisë nga institucionet përkatëse qeveritare, përgjegjësinë e tyre mbikëqyrëse brenda kornizës së kontrollit civil demokratik, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Ngjarjet e fundit ndërkombëtare si pandemia e COVID-19, migrimi, ndryshimet klimatike, agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës, kriza në Lindjen e Mesme, konkurrenca në rritje midis demokracive dhe autoritarizmit, e kanë sjellë sigurinë gjithnjë e më shumë në epiqendrën e shqetësimeve të qytetarëve. Qeveritë po i përgjigjen këtyre shqetësimeve duke mbështetur sigurinë përmes një sërë reformash që synojnë të trajtojnë ndryshimet klimatike, migracionin, qëndrueshmërinë shoqërore ndaj ndikimeve malinje dhe së fundmi, rritjen e shpenzimeve për mbrojtjen dhe sigurinë.

Ky edicion i Barometrit të Sigurisë fokusohet në disa tema, shumica e përshtatur kryesisht nga këndvështrimi i sigurisë njerëzore. Qasja e sigurisë njerëzore e zhvilluar nga Kombet e Bashkuara është plotësuese me qasjen e sigurisë shtetërore dhe bazohet në premisën se privimet e sigurisë njerëzore mund të dëmtojnë paqen dhe stabilitetin brenda dhe ndërmjet shteteve. Kuadri i sigurisë njerëzore ofron një qasje gjithëpërfshirëse, të përqendruar te njerëzit dhe të orientuar nga parandalimi, që përfshin kërcënimet në shtatë fusha: siguria personale, siguria e komunitetit, siguria politike, siguria ekonomike, siguria ushqimore, siguria shëndetësore, siguria mjedisore.²

Ndër fushat e sigurisë njerëzore, ky edicion i Barometrit të Sigurisë fokusohet në sigurinë politike, sigurinë ekonomike, sigurinë ushqimore, sigurinë shëndetësore dhe sigurinë personale, megjithëse kjo e fundit është analizuar nga një këndvështrim më i ngushtë i maskulinitetit, i cili mund të luajnë një rol në nxitjen e konfliktit dhe pasigurisë.

Së pari, barometri shqyrton perceptimin e qytetarëve për kërcënimet e sigurisë në nivel kombëtar dhe ndikimin e perceptuar të vendeve të ndryshme me ndikim global ose rajonal dhe vendeve të Ballkanit në Shqipëri. Duke pasur parasysh natyrën specifike të marrëdhënieve me Kosovën dhe Serbinë, kjo anketë

¹ Security Sector Reform. SSR Background Series. CAF – Geneva Centre for Security Sector Governance. Geneva: DCAF, 2019.

² Haq, M., Kaul, I., Menon, S., & Jahan, S. (1994). Human Development Report 1994: New dimensions of human security. New York: UNDP.

shqyrton edhe opinionet e qytetarëve për marrëdhëniet e tanishme dhe të ardhshme me këto vende.

Së dyti, anketa fokusohet në aspekte që lidhen me sigurinë politike. Pyetjet në këtë pjesë të anketës synojnë të kapin opinionet e qytetarëve për përfaqësimin politik dhe vlerat demokratike, fuqizimin e qytetarëve dhe mbështetjen e tyre për politikën, si dhe pikëpamjet e tyre mbi performancën e qeverisë në fushat përkatëse të politikave për sigurinë njerëzore dhe pavarësinë politike të SPAK dhe Gjykatave të Posaçme.

Në vijim, anketa fokusohet në sigurinë ekonomike. Pyetjet në këtë seksion synojnë të kuptojnë se sa të sigurt ndihen qytetarët shqiptarë për sa i përket mjaftueshmërisë dhe stabilitetit të të ardhurave të tyre aktuale dhe të ardhshme, si dhe sigurinë e tyre të punësimit.

Siguria ushqimore fokusohet në mjaftueshmërinë dhe cilësinë e ushqimit dhe në sigurinë e produkteve të konsumatorëve ushqimorë.

Siguria shëndetësore fokusohet në çështjet që lidhen me aksesin dhe cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, si dhe pasigurinë e qytetarëve lidhur me mundësinë e tyre për të aksesuar shërbime të tilla.

Tema e mëposhtme eksploron sigurinë personale dhe të komunitetit nga këndvështrimi i maskulinitetit. Disa studime kërkimore tregojnë se normat gjinore të ndërhuara nga shoqëria e lidhin maskulinitetin me pushtetin, dhunën dhe kontrollin dhe lënia e paadresuar e këtyre normave mund të luajë një rol në nxitjen e konfliktit dhe pasigurisë. Ky seksion i anketës përpiqet të eksplorojë më thellë në gjetjet e Barometrit të Sigurisë 2022 mbi sigurinë dhe integrimin gjinor.

Tema e fundit e këtij Barometri të Sigurisë synon të kapë mbështetjen dhe pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë për procesin e anëtarësimit në BE. Agjenda e anëtarësimit në BE ka fituar një vull të ri veçanërisht për shkak të luftës në Ukrainë, duke e lidhur këtë proces me shqetësimet e sigurisë që mund të prekin rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Qëllimi i Barometrit të Sigurisë është të ofrojë një kuptim më të mirë të perceptimeve dhe opinionëve të qytetarëve mbi kërcënimet dhe sfidat kryesore të sigurisë dhe të lejojë politikëbërësit dhe institucionet qeveritare të ndërmarrin politika të cilat bazohen në të dhëna për të adresuar dhe për t'iu përgjigjur këtyre kërcënimeve dhe sfidave.

Metodologjia

PYETËSORI

Pyetëtori i përdorur për këtë anketë përbëhet nga 115 pyetje me shumë zgjedhje, prej të cilave 6 janë demografike. Pyetëtori përfshin dy pyetje të paraqitura në mënyrë vijuese mbi kërcënimin më serioz të sigurisë dhe kërcënimin e dytë më serioz të sigurisë, si dhe dy pyetje të paraqitura mbi çfarë do të thotë BE-ja për pjesëmarrësit në anketë (shih Aneksin 3). Qëllimi i kombinimit të këtyre dy pyetjeve është që nëpërmjet të dhënave të grumbulluara përmes pyetjeve të mblidhen më shumë zgjedhje të përbashkëta nga të njëjtët të anketuar.

KAMPIONIMI

Për këtë anketë u përdor një kampion i rastësishëm me shumë shtresa prej 1121 të rriturish. Në shtresën e parë, pyetëtorët u shpërndanë proporcionalisht në 61 bashki të Shqipërisë, bazuar në popullsinë e të rriturve (shih Aneksin 2). Në shtresën e dytë, vëzhgimet u shpërndanë proporcionalisht midis zonave urbane/periferike dhe rurale brenda çdo bashkie, për të reflektuar shpërndarjen e popullsisë shqiptare. Po kështu, për çdo nënshtresë u aplikuan kuota gjinore dhe moshe 50%-50% për secilën nënshtresë. Së fundi, nga harta e Shqipërisë u zgjedhën në mënyrë të rastësishme pika gjeografike për intervistat, sipas skemës së mësipërme të kampionimit (shih Aneksin 1).

Qëllimi i kësaj qasjeje kampionimi me shumë shtresa ishte të arrihej një përfaqësim i saktë gjeografik dhe demografik i popullsisë së të rriturve të Shqipërisë, duke ruajtur një gabim kampionimi më të ulët se $\pm 2.9\%$ për kampionin e plotë. Ky kampionim i rastësishëm me shumë shtresa siguron që çdo banor në Shqipëri të ketë probabilitet të barabartë për t'u zgjedhur për të marrë pjesë në anketë.

Duke përdorur këtë metodë kampionimi, rezultatet e anketës pasqyrojnë në mënyrën më realiste qëndrimet dhe perceptimet e popullsisë së përgjithshme të të rriturve në Shqipëri. Marzhi i gabimit statistikor për pjesën e meshkujve dhe të femrave të kampionit është llogaritur në $\pm 4,1\%$, $\pm 3,9\%$ për përfaqësimin urban të kampionit dhe në $\pm 4,3\%$ për zonat rurale dhe periferike, $\pm 5.1\%$ për arsimin universitar dhe $\pm 3.6\%$ për pa arsim universitar.

MBLEDHJA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

Kjo anketë është realizuar nëpërmjet intervistave ballë për ballë, sipas planit të kampionimit të mësipërm. Para fillimit të punës në terren, 34 intervistuesit u trajnuan nga ekipi i menaxhimit të projektit.

Puna në terren për mbledhjen e të dhënave u krye gjatë periudhës nga 6 deri 13 prill 2024. Përgjigjet e të intervistuarve u hodhën drejtpërdrejt nga intervistuesit në telefonat inteligjentë dhe u transmetuan menjëherë në serverin qendror përmes një programi softuerik të posaçëm, të ndërtuar nga Specialisti i TI të projektit.

Koha dhe vendndodhja e secilës intervistë regjistrohej automatikisht. Ky informacion përdorej çdo ditë nga drejtori i statistikave për t'u siguruar që intervistat ishin kryer në përputhje me planin e paracaktuar të kampionimit dhe udhëzimet metodologjike.

Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave, u krye një kontroll i përgjithshëm i cilësisë së të dhënave të intervistave të mbledhura në server. Përpara analizës së të dhënave, kampioni u ripeshua për të pasqyruar shpërndarjen proporcionale të moshës siç raportohet nga Instituti i Statistikave. Gjithashtu, kampioni u ripeshua politikisht, për të përfaqësuar stilistikisht përqindjet e regjistruara në zgjedhjet e fundit të përgjithshme të vitit 2021. Më pas, të dhënat u përpunuan dhe u analizuan duke përdorur softuerin statistikor STATA 13.

ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat janë mbledhur, përpunuar dhe analizuar duke i grupuar përgjigjet në temat kryesore të mëposhtme.

1. Informacioni demografik
2. Kërcënimet e sigurisë dhe marrëdhëniet me vendet e tjera
3. Siguria politike
4. Siguria ekonomike
5. Siguria ushqimore
6. Siguria shëndetësore
7. Maskuliniteti si burim i pasigurisë gjinore
8. Anëtarësimi në BE
9. Performanca e qeverisë dhe e gjyqësorit

Analiza synon të paraqesë audiencave të dhëna të papërpunuara. Janë bërë disa interpretime, kryesisht mbi arsyetimin për përzgjedhjen e pyetje-s/ve të dhëna dhe tendencave ndër vite të interpretuara përmes lenteve të zhvillimeve përkatëse. Të dhënat paraqiten në grafikë për t'i bërë ato më të kuptueshme dhe të lexueshme për lexuesit. Numrat në grafikë paraqiten në përqindje.

Gjetjet kryesore

KËRCËNIMET PËR SIGURINË DHE MARRËDHËNIET ME VENDET E TJERA



Korrupsioni është identifikuar si kërcënim më serioz i sigurisë për shumicën e të anketuarve. Krahasuar me anketat e mëparshme, ka një përafrim më të qartë me politikën e jashtme të Shqipërisë për sa i përket ndikimit të perceptuar të fuqive globale dhe rajonale ndaj Shqipërisë; megjithatë, Kina shihet mjaft pozitivisht. Serbia është i vetmi vend që shihet si një kërcënim për sigurinë e Shqipërisë dhe gjithashtu një përçindje e vogël për Greqinë, por shumica mbështesin marrëdhëniet më të ngushta me Serbinë. Ka më shumë mbështetje për bashkëpunim më të ngushtë me Kosovën sesa për bashkim. Qytetarët shqiptarë janë përkrahës të Ukrainës në luftën e saj kundër Rusisë, por nuk e mbështesin Izraelin.



Shumica dërrmuese e qytetarëve mendojnë se korrupsioni është kërcënim më serioz për sigurinë e Shqipërisë. Korrupsioni është identifikuar si kërcënim kryesor i sigurisë që kur barometri u krye për herë të parë në vitin 2019, por përqindja e qytetarëve që e identifikojnë korrupsionin si kërcënimin kryesor të sigurisë në këtë anketë është më e lartë se në vitet e mëparshme.³ Një përqindje më e madhe e qytetarëve e shohin krimin e organizuar si kërcënim në krahasim me anketat e mëparshme, ndërsa më pak e shohin si kërcënim luftën me vendet e tjera.

³ Barometri Sigurisë Shqipëri 2019. <https://csdgalbania.org/al/wp-content/uploads/2023/03/Barometri-shqip-FINAL-1.pdf>

Barometri Sigurisë Shqipëri 2020. https://csdgalbania.org/al/wp-content/uploads/2023/03/barometri_i_sigurise_2020_SHQIP-WEB.pdf

Barometri Sigurisë Shqipëri 2022. https://csdgalbania.org/al/wp-content/uploads/2022/06/barometri_i_sigurise_2022_SHQIP-WEB.pdf



Shumica e qytetarëve shqiptarë e shohin ndikimin e Shteteve të Bashkuara ndaj Shqipërisë si pozitiv ose shumë pozitiv. Rezultatet e sondazhit tregojnë të njëjtën tendencë për Turqinë. Më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se ndikimi i Kinës ndaj Shqipërisë nuk është as pozitiv dhe as negativ. Pjesa tjetër ndahet pothuajse në mënyrë të barabartë midis ndikimit pozitiv dhe negativ. Për sa i përket Ruisë dhe Iranit, rezultatet tregojnë tendenca thujse identike: vetëm një pakicë shumë e vogël mendon se ndikimi i këtyre vendeve ndaj Shqipërisë është pozitiv.



Shumica e qytetarëve janë për një marrëdhënie më të ngushtë mes Shqipërisë dhe Kosovës. Megjithatë, një përqindje më e lartë mbështet unifikimin e politikës së tyre të jashtme në vend të bashkimit të vendeve.



Sa i përket marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, shumica e të anketuarve mendojnë se të dyja vendet do të arrijnë një marrëveshje përfundimtare mbi normalizimin e marrëdhënieve në të ardhmen e afërt, por më shumë se një e treta mendojnë se kjo nuk do të ndodhë kurrë. Pavarësisht marrëdhënieve problematike mes Kosovës dhe Serbisë, shumica dërrmuese mendon se Shqipëria dhe Serbia duhet të kenë bashkëpunim më të madh mes tyre.



Të anketuarit kanë pikëpamje shumë të ndryshme për qëndrimin e Shqipërisë në lidhje me dy konfliktet aktuale më të rëndësishme të armatosura, të cilat po formësojnë aktualisht sigurinë dhe politikën ndërkombëtare. Një shumicë dërrmuese thotë se Shqipëria duhet t'i japë mbështetje Ukrainës, ndërsa pothuajse e njëjta shumicë është kundër një mbështetjeje të tillë për Izraelin. Tendencë e ngjashme vërehet në përgjigjet kur pyeten nëse komuniteti perëndimor duhet të vendosë sanksione ndaj Ruisë dhe Izraelit, megjithëse një përqindje më e madhe favorizon sanksionet kundër Izraelit.



Një përqindje shumë e madhe e qytetarëve mendojnë se Serbia është një kërcënim i sigurisë për Shqipërinë dhe një përqindje më e vogël prej 17.6% mendojnë kështu për Greqinë. Asnjë nga vendet e tjera të Ballkanit nuk shihet si kërcënim për sigurinë e Shqipërisë.

SIGURIA POLITIKE



I përshtatur si koncept në vitet 1990, siguria politike është lidhur me parandalimin e represionit të qeverisë, parandalimin e shkëlqes sistematike të të drejtave të njeriut dhe heqjen e kërcënimeve nga militarizimi. Në këtë anketë, pyetjet për sigurinë politike u përpiluan për të marrë opinionin e qytetarëve për marrëdhëniet midis qytetarëve dhe shtetit në kuptimin e përfaqësimit nga institucionet politike, shkallën në të cilën qytetarët ndihen të autorizuar për t'i mbajtur përgjegjës zyrtarët politikë dhe lirinë për të zgjedhur alternativat politike.

Rezultatet e sondazhit tregojnë se një shumicë dërrmuese e të anketuarve nuk ndihen të përfaqësuar nga institucionet demokratike të vendit. Ekziston një besim i moderuar në fuqinë e qytetarëve për të hequr qeverinë që nuk u pëlqen me mjete demokratike dhe se zgjedhjet e ardhshme të vitit 2025 nuk do të prodhojnë ndryshime në drejtim të fuqizimit të qytetarëve për të zgjedhur lirisht alternativat politike. Rezultatet tregojnë se qytetarët ndihen të kufizuar në lirinë e tyre për të shprehur kritikën ndaj qeverisë.



Shumica e qytetarëve shqiptarëve nuk ndihen të përfaqësuar nga institucionet e tyre demokratike. Më pak qytetarë ndihen të përfaqësuar nga parlamenti, pak më shumë nga qeveria dhe pushteti vendor. Rezultatet tregojnë tendenca të ngjashme lidhur me pyetjet nëse përfaqësuesit politikë janë të fokusuar në zbatimin e vullnetit të votuesve dhe nëse zgjedhjet ofrojnë një zgjedhje reale të alternativave politike.



Shumica e qytetarëve mendojnë se drejtuesit e qeverisë shkelin ligjin ose abuzojnë me pushtetin e tyre gjithmonë ose shumicën e kohës dhe se krimet e kryera nga zyrtarët e qeverisë mbeten të pandëshkuara gjithmonë ose shumicën e kohës. Një përqindje e vogël e qytetarëve mendojnë se parlamenti mund ta mbajë qeverinë nën kontroll dhe llogaridhënie.



Shumica e të anketuarve mendojnë se qytetarët e thjeshtë shqiptarë kanë pak ndikim në atë që bën qeveria, ndërsa shumica mendojnë se ajo që bën qeveria është e ndikuar nga pronarët e bizneseve të mëdha.



Më shumë se gjysma e të anketuarve thonë se qytetarët në Shqipëri janë të lirë të shprehin hapur kritikën e tyre për qeverinë apo pikëpamjet e tyre politike pa frikë. Më pak njerëz mendojnë kështu për median, dhe vetëm një e pesta mendon se zyrtarët e administratës publike mund të shprehin pikëpamjet e tyre politike, pa frikë.



Të anketuarit janë pothuajse njëlloj të ndarë lidhur me nëse kanë fuqinë për të ndryshuar me mjete demokratike një qeveri që nuk u pëlqen. Në mënyrë të ngjashme, ato janë pothuajse të ndarë përgjysëm kur pyeten nëse zgjedhjet e ardhshme parlamentare të parashikuara të mbahen në vitin 2025 do të jenë të lira dhe të ndershme.



Rezultatet e anketës tregojnë një trend të favorshëm sa i përket përfshirjes së komuniteteve fetare në politikëbërje. Më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se autoritetet qeveritare duhet të konsultohen me komunitetet fetare gjatë miratimit të ligjeve.

SIGURIA EKONOMIKE



Siguria ekonomike është aftësia e individëve, familjeve ose komuniteteve për të mbuluar nevojat e tyre thelbësore në mënyrë të qëndrueshme dhe me dinjitet,⁴ është kushti për të pasur të ardhura të qëndrueshme ose burime të tjera për të mbështetur një standard jetese në të tashmen dhe në një të ardhme të parashikuar. Siguria ekonomike është një element kryesor për qëndrueshmërinë e një kombi dhe sigurinë

⁴ Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 2010. "Përmbledhje e punës së KNKK-së për të promovuar sigurinë ekonomike"

e tij kombëtare. Pyetjet e sondazhit u hartuan për të marrë opinionin e qytetarëve mbi gjendjen e ekonomisë shqiptare, sigurinë e të ardhurave personale dhe aksesin në punë, në të tashmen dhe në të ardhmen. Rezultatet tregojnë se rreth një e treta e popullsisë ka pasiguri ekonomike dhe pasiguri që lidhen me punën.



Shumica e qytetarëve mendojnë se gjendja aktuale e ekonomisë së vendit është as e mirë, as e keqe apo e keqe. Krahasuar me një vit më parë, gjysma thonë se është pothuajse e njëjta gjë, ndërsa një e pesta mendon se është më mirë. Gati dy të tretat thonë se cilësia e jetës në Shqipëri nuk është as e mirë, as e keqe apo e keqe. Një e treta thotë se cilësia e jetës në vend është shumë e mirë ose e mirë.



Mbi dy të tretat thonë se gjendja aktuale financiare e familjes së tyre nuk është as e mirë as e keqe, shumë e keqe ose e keqe. Një e pesta thonë se kanë një situatë më të mirë financiare në familje, ndërsa gati tre të pestat nuk kanë pasur asnjë ndryshim.



Mbi një e treta e të anketuarve pret të jenë në një situatë më të mirë financiare në një ose dy vitet e ardhshme dhe vetëm rreth një e gjashta thonë se do të jetë më keq. Megjithatë, gati dy të tretat janë të shqetësuar se nuk do të jenë në gjendje të mirë ekonomike dhe të sigurt financiarisht tre deri në pesë vitet e ardhshme. Pak më shumë janë të shqetësuar se nuk do të jenë të sigurt financiarisht në një moshë të avancuar. Megjithatë, tendenca është e ndryshme për strehimin: shumica thonë se nuk janë fare ose janë më pak të shqetësuar për të gjetur një banesë të përshtatshme ose për të mbajtur atë që kanë.



Shumica dërrmuese thonë se mbështetja që u jepet të papunëve nga qeveria është e pamjaftueshme. Në rast të një situatë të trazuar financiare shumica thonë se presin të marrin mbështetje nga familja dhe miqtë dhe jo nga qeveria.



Shumica e qytetarëve thonë se hendeku mes të pasurve dhe të varfërve është rritur gjatë pesë viteve të fundit për shkak të politikave të qeverisë. Vetëm rreth një e pesta thonë se qeveria merr parasysh pikëpamjet e qytetarëve kur harton apo reformon politikat ekonomike. Megjithatë, rreth dy të tretat thonë se midis demokracisë dhe zhvillimit ekonomik do të zgjidhnin zhvillimin ekonomik si më të rëndësishëm.



Shumica e të anketuarve mendojnë se bujqësia dhe turizmi janë sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë së Shqipërisë.



Një pjesë e vogël e të anketuarve thonë se është e lehtë të gjesh një punë në Shqipëri, rreth një e katërta thonë se është disi e lehtë ndërsa për dy të tretat e qytetarëve nuk është e lehtë. Sa i përket aksesit në punë nga femrat apo meshkujt, gjysma e të anketuarve thonë se është e njëjtë për të dyja gjinitë, ndërsa rreth një e treta mendojnë se është më e lehtë për meshkujt.



Vetëm rreth një e treta thonë se punëdhënësit në sektorin privat ofrojnë pagesë të mjaftueshme, dhe një përqindje pak më e lartë thonë se kushtet e punës në sektorin privat janë të mira. Qytetarët janë të ndarë në përgjigjen e tyre për shqetësimet e mospasjes së aftësive dhe njohurive të duhura për të punuar në një punë të qëndrueshme dhe të mirëpaguar ose nëse kanë frikë se do të humbasin vendin e punës ose të ardhurat nga vetëpunësimi në vitin e ardhshëm. Megjithatë, rreth dy të pestat e të anketuarve thonë se janë deri diku ose shumë të shqetësuar.



Një e pesta thonë se qeveria ka bërë përpjekjet e duhura për të krijuar në Shqipëri vende pune për të gjithë. Megjithatë, tre të pestat e të anketuarve thonë se shqiptarët duhet të bëjnë përpjekje për të gjetur punë dhe punuar në Shqipëri, por një përqindje e konsiderueshme thonë se duhet të kërkojnë punë në vende të tjera.

SIGURIA USHQIMORE



Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) përcakton sigurinë ushqimore si: "kur të gjithë njerëzit kanë në çdo kohë akses në ushqim të mjaftueshëm, të sigurt, me

vlera ushqyese për të mbajtur një mënyrë jetese të shëndetshme dhe aktive”.⁵ Rezultatet tregojnë se rreth një e pesta deri në një e treta e qytetarëve të anketuar kanë pasiguri ushqimore për sa i përket mjaftueshmërisë dhe cilësisë së lëndëve ushqyese, dhe shumica më e madhe e raportojnë këtë pasiguri për sa i përket sigurisë ushqimore.



Rreth dy të tretat janë përgjigjur se gjatë vitit të kaluar kanë mundur të përballojnë ushqimin dhe se nuk kanë patur nevojë të zvogëlojnë sasinë e ushqimit për arsye financiare. Një e treta tjetër thanë se u duhej të reduktonin ushqimin çdo muaj, për një ose dy ose disa muaj.



Rreth gjysma e të anketuarve thonë se ishin të shqetësuar se ushqimi do të mbaronte para se të merrnin para për ta blerë përsëri. Një e katërta e të anketuarve thonë se janë më të shqetësuar për plotësimin e nevojave të tyre për ushqim vitin e ardhshëm.



Për cilësinë e ushqimit, dy të tretat thonë se jo gjithmonë kanë pasur mundësi të blinin ato ushqime që dëshironin të kishin. Katër të pestat e të anketuarve mendojnë ose anojnë të mendojnë se kontrollet e sigurisë ushqimore nga institucionet shtetërore nuk janë të duhurat; Një përqindje e ngjashme mendon se produktet ushqimore që shiten në tregjet shqiptare nuk janë të sigurta dhe mund të jenë të dëmshme për shëndetin e tyre.

SIGURIA SHËNDETËSORE



Siguria shëndetësore është një ndjenjë sigurie për të qenë në gjendje për të marrë ndihmë mjekësore për veten dhe të afërmit kur ata kanë djeni për një nevojë të tillë. Siguria shëndetësore është një koncept relativ kur hulumtohet në vendet në zhvillim

⁵ Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë. 1996. Deklarata e Romës për Sigurinë Botërore të Ushqimit dhe Plani i Veprimit i Samitit Botëror të Ushqimit.

apo të zhvilluara. Kjo anketë është përpjekur të marrë informacione për opinionin e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimeve shëndetësore publike, aksesin dhe përballueshmërinë. Rezultatet tregojnë se një përqindje e madhe e qytetarëve shqiptarë kanë probleme me aksesin dhe cilësinë e sistemit shëndetësor publik, dhe për rreth një të pestën deri në një të katërtën e popullsisë është problem përballueshmëria.



Rreth një e treta i vlerësojnë spitalet publike në zonën e tyre si të mira, ndërsa mbi një e pesta thonë se cilësia e shërbimeve është e dobët. Shumica thonë se shërbimi është mesatar.



Rreth një e treta thonë se kanë marrë shërbim shëndetësor në një spital publik vitin e fundit dhe një e pesta kanë marrë shërbime mjekësore nga një spital privat, por një e treta thonë se zgjedhja e tyre e parë do të ishte një spital privat.



Një e pesta thonë se i shmangen marrjes së shërbimeve mjekësore për shkak se nuk i përballojnë dot, ndërsa një e katërta thonë se gjatë vitit të kaluar ata ose një anëtar i familjes kanë aplikuar terapi alternative për të shmangur spitalin dhe për të kursyer para. Mbi dy të tretat e të anketuarve thonë se janë të shqetësuar për aftësinë e tyre për të paguar faturat mjekësore në rast të sëmundjes ose aksidentit. Gjysma e tyre thonë se janë të shqetësuar ose shumë të shqetësuar se nuk do të kenë mundësi të kenë kujdes shëndetësor të duhur për veten e tyre në të ardhmen.



Vetëm gjysma e të anketuarve thonë se qasja në shërbimet publike shëndetësore ka qenë e lehtë ose shumë e lehtë, bazuar në përvojën e tyre në vitet e kaluara. Një e pesta thonë se mjekët dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor në institucionet publike shëndetësore gjithmonë i trajtojnë pacientët me respekt dhe konsideratë, tre të pestat e tjera thonë se kjo ndodh vetëm ndonjëherë.



Vetëm një e treta e të anketuarve besojnë se barnat që shiten në Shqipëri janë të sigurta dhe jo të dëmshme për shëndetin e tyre.

MASKULINITETI DHE SIGURIA GJINORE



Maskuliniteti përfshin ato sjellje, gjuhë dhe praktika, që ekzistojnë në vende specifike kulturore dhe organizative, të cilat zakonisht lidhen me burrat, pra të përcaktuara kulturalisht si jo femërore. Dhuna me bazë gjinore lidhet nga studime të shumta me konceptet dhe konstruksionet e maskulinitetit dhe feminitetit ndaj të cilave njerëzit janë të ekspozuar që në moshë të re. Pyetjet e këtij sondazhi u ndërtuan me synimin për të kapur shkallën në të cilën maskuliniteti është i pranishëm në shoqërinë shqiptare, si burim i pasigurisë personale nga ana e grave. Rezultatet tregojnë se në përgjithësi shoqëria shqiptare vlerëson maskulinitetin dhe mendon se rolet shoqërore janë të dallueshme sipas gjinisë. Rezultatet tregojnë gjithashtu se maskuliniteti i ndërtuar shoqërisht, bazohet në supozime dhe njohje, për shembull kur caktohen disa profesione ose role shoqërore që të jenë të përshtatshme ose të papërshtatshme për grate



Shumica e të anketuarve pajtohen se gratë dhe burrat duhet të angazhohen në mënyrë të barabartë në politikë. Në mënyrë të ngjashme, ata mendojnë se gratë dhe burrat janë njësoj të aftë për të bërë një punë në funksione politike dhe se gratë dhe burrat duhet të paguhen në mënyrë të barabartë. Rreth një e treta mendojnë se në realitet gratë në Shqipëri nuk kanë të njëjtat mundësi si burrat për t'u futur në politikë. Ndryshe nga aftësia e grave për të kryer punë në funksione politike, dy të pestat e të anketuarve thonë se gratë nuk janë të afta të punojnë në punë ushtarake dhe policore.



Mbi një e pesta e të anketuarve mendojnë se do të ishte më mirë që gruaja të mos shkojë në punë nëse familja është në gjendje të mirë financiare dhe një përqindje e ngjashme mendojnë se burri nuk duhet të kalojë kohë me fëmijët aq sa gruaja. Mbi një e treta mendojnë se burrat duhet të thonë fjalën e fundit kur në familje merren vendime të rëndësishme.



Pothuajse njëzëri, të anketuarit janë kundër përdorimit të shuplakës nga një burrë ndaj gruas ose partneres së tij, edhe kur ajo bën diçka të gabuar. Megjithatë, gjysma e tyre mendojnë se si burrat ashtu edhe gratë janë përgjegjës për dhunën e ushtruar nga burrat ndaj grave.



Shumica dërrmuese e lidh burrërinë me kontrollin e emocioneve. Mbi dy të tretat mendojnë se një mashkull i vërtetë duhet të kontrollojë emocionet dhe të mos shfaqë dobësi. Një e katërta e të anketuarve thotë se nëse ata do të kishin zgjedhjen për të vendosur do të ishte më mirë që një çift të kishte vetëm djem.

ANËTARËSIMI NË BE



Qytetarët shqiptarë mbeten pothuajse unanimitisht mbështetës të BE-së dhe shumica besojnë se Shqipëria do të bëhet anëtare e BE-së brenda pesë ose dhjetë viteve të ardhshme.



Të anketuarit thuajse njëzëri thonë se anëtarësimi në BE do të jetë një gjë e mirë për Shqipërinë dhe shumica e qytetarëve thonë se Shqipëria duhet të ndjekë reformat e nevojshme për t'u bërë anëtare e BE-së.




Anketa shqyrtoi gjithashtu shkallën në të cilën të anketuarit përqafojnë narrativat pro-BE apo euroskeptike. Një përqindje shumë e madhe e qytetarëve janë përkrahës të BE-së. Rreth një e treta e lidh BE-në me prosperitetin ekonomik, ndërsa një e katërta e lidh atë me lirinë për të udhëtuar, studiuar dhe punuar kudo në BE. Përqindje më të vogla e lidhin BE-në me demokracinë, mbrojtjen sociale, pozitën më të fortë në botë të Shqipërisë apo diversitetin kulturor.



Gati dy të tretat mendojnë se Shqipëria do të bëhet anëtare e BE-së brenda pesë ose dhjetë viteve të ardhshme, rreth një e treta mendojnë se Shqipëria do të bëhet anëtare e BE-së brenda njëzet vitesh. Vetëm një përqindje e vogël mendon se kjo nuk do të ndodhë kurrë.

PERFORMANCA E QEVERISË DHE E GJYQËSORIT



Sondazhi mori gjithashtu opinionin e qytetarëve edhe për performancën e qeverisë në sektorët që lidhen me ofrimin e sigurisë njerëzore, si dhe për pavarësinë politike dhe performancën e Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe SPAK.



Tre të pestat thonë se në përgjithësi Shqipëria po shkon në drejtimin e duhur. Të anketuarit janë të ndarë për punën e qeverisë në përgjithësi. Rreth një e treta thonë se performanca e qeverisë është e mirë ose shumë e mirë, një e treta tjetër se është e keqe ose shumë e keqe dhe një e treta tjetër se performanca e qeverisë nuk është as e mirë as e keqe.



Përsa i përket performancës së qeverisë në sektorë të ndryshëm, performanca në turizmin shihet si e mirë ose shumë e mirë nga shumica e qytetarëve, rreth gjysma mendojnë të njëjtën gjë për sigurinë dhe rendin publik.



Rreth një e treta thonë se performanca e qeverisë në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit është e mirë ose shumë e mirë. Më pak se një e pesta e qytetarëve mendojnë se performanca e qeverisë është e mirë ose shumë e mirë në bujqësi, punësim dhe luftë kundër korrupsionit.




Të anketuarit janë pothuajse njëloj të ndarë për pavarësinë nga politika të Gjykatave të Posaçme dhe SPAK, me një shumicë të lehtë që thonë se vendimmarrja e tyre ndikohet nga politika.




Rreth dy të tretat thonë se SPAK është serioz në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhe pak më shumë qytetarë mendojnë kështu për korrupsionin.

Informacion demografik

Kampioni përfshinte 1121 të anketuar: 50.8% meshkuj dhe 49.2% femra. Përsa i përket grupmohave, kampioni ka kapur një shpërndarje pothuajse të barabartë të katër grupmohave, me një numër pak më të lartë të moshave 18-34 vjeç.




Grafikët 1 dhe 2. Shpërndarja e moshës dhe gjinisë në përqindje




Grafik 3. Niveli i arsim

Shumica e popullsisë së anketuar banon në zonat urbane dhe rrethinat e qytetit, përkatësisht 54.4% dhe 11.6%. Gati një e treta, 34.1%, e të anketuarve jetojnë në zonat rurale.




Grafikët 4 dhe 5. Vendbanimi dhe vendndodhja e punës

Sa i përket përkatësisë etnike, 97.5% e kanë identifikuar veten si shqiptarë, 1% arumunë, 0.6% grekë, 0.6% maqedonas dhe 0.2% të tjerë.



Grafik 6. Etnia


Për sa i përket profesionit, grupimi më i madh, 21.1% janë të vetëpunësuar, pasuar nga 20.8% pensionistë dhe 17.2% punëtorë të pakualifikuar. Grafik më poshtë përshkruan ndarjen e plotë të të anketuarve sipas angazhimit profesional.



Grafik 7. Profesioni

Duke pasur parasysh rritjen e rolit të fesë në shoqëri gjatë viteve të fundit, anketa kapi shpërndarjen fetare dhe pjesëmarrjen në shërbesa fetare. Rezultatet tregojnë se shumica prej 57.7% identifikohen si myslimanë sunitë ndërsa 10.6% të tjerë si bektashi. 24.6% identifikohen si kristianë, nga të cilët 12.7% si ortodoksë kristianë, 11.9% si katolikë dhe 0.5% si protestantë. 6.6% identifikohen si ateistë ose afetarë.


Në cilën fe besoni, nëse besoni?



Grafik 8. Shpërndarja fetare

Për sa i përket shpeshësisë së frekuentimit të shërbesave fetare, 17.9% ndjekin rregullisht praktikën fetare nga çdo javë deri në çdo muaj. Vetëm 7.9% praktikojnë fenë rregullisht në baza javore. Ekziston një korrelacion ndërmjet nivelit të arsimit dhe frekuentimit të shërbesave fetare. 11.5% e atyre që nuk kanë arsim universitar ndjekin shërbesat fetare çdo javë ose çdo dy javë, kundrejt 8% të atyre që kanë arsim universitar. Një numër më i madh i të anketuarve me arsim universitar deklarohen si ateistë (9.3%), krahasuar me ato pa arsim universitar (3.4%).

Sa shpesh shkoni në xhami/kishë/teqe/tjetër?



Grafik 9. Shpeshësia e frekuentimit të shërbesave fetare

Kërcënimet e sigurisë dhe marrëdhëniet me vendet e tjera


Identifikimi i kërcënimeve kryesore të sigurisë për Shqipërinë ka qenë një tipar kyç i barometrit ndër vite. Të anketuarve u kërkohet rregullisht të identifikojnë kërcënimin e parë më serioz të sigurisë dhe kërcënimin e dytë më serioz të sigurisë për Shqipërinë. Në vitin 2024, 45% e identifikuan korrupsionin si kërcënimin më serioz të sigurisë, i ndjekur nga krimi i organizuar me 23.8% dhe lufta me 17.6%.

Përqindja e qytetarëve që e identifikojnë korrupsionin si kërcënimin kryesor të sigurisë në këtë anketë është më e lartë se në vitet e mëparshme (39.3% në 2022, 36.9% në 2020). Krimi i organizuar gjithashtu identifikohet si kërcënim për sigurinë nga një përqindje më e madhe e qytetarëve, 23.8% krahasuar me anketat e mëparshme (19.2% në 2022, 20.3% në 2020). Kërcënime të tjera që janë identifikuar nga më shumë qytetarë krahasuar me vitet e mëparshme janë krimi kibernetik 7% (0.7% në 2022), migrantët e huaj 4,3% (1% në 2022 dhe 0.8% në 2020). Më pak qytetarë e konsiderojnë luftën me vendet e tjera (30.2% në 2022 dhe 7.62% në 2020) dhe terrorizmin (4.8% në 2022 dhe 10.67% në 2020), si kërcënime kryesore.

Marrëdhëniet me vendet e tjera dhe qëndrimet pozitive apo negative për vende të ndryshme janë një tjetër tipar kyç i Barometrit të Sigurisë. Këto të dhëna synojnë të japin një kuptim sesi pikëpamjet e të anketuarve për sigurinë janë formësuar nga zhvillimet dhe ndërveprimet ndërkombëtare. Ndërkohë që konkurrenca për ndikim në botë është intensifikuar gjithnjë e më shumë gjatë viteve të fundit, ky edicion ka marrë opinione mbi ndikimin e tri fuqive të mëdha botërore, SHBA-së, Kinës dhe Ruisë, si dhe dy fuqive rajonale, Iranit dhe Turqisë. Të anketuarve iu drejtua pyetja *“Cili mendoni se është ndikimi i (vendit) ndaj Shqipërisë?”* për secilin nga vendet e lartpërmendura.


Shumica e qytetarëve shqiptarë mendojnë se SHBA-të kanë një ndikim pozitiv ose shumë pozitiv ndaj Shqipërisë (78%). 17.4% mendojnë se ndikimi i SHBA-së nuk është as pozitiv dhe as negativ. Përgjigjet për Turqinë tregojnë pothuajse të njëjtat rezultate me ato të SHBA-së. Kina është vendi ndaj të cilit shumica e shqiptarëve janë ambivalent. 53.9% mendojnë se ndikimi i Kinës nuk është as pozitiv dhe as negativ, ndërsa 21.6% mendojnë se ndikimi i Kinës është pozitiv ose shumë pozitiv. Rusia dhe Irani shihen pothuajse njësoj nga shqiptarët, megjithëse përqindja e atyre që mendojnë se ndikimi i Iranit është negativ është pak më e vogël.

Kërcënimi aktual më serioz për Shqipërinë



Grafik 10. Kërcënime për sigurinë e Shqipërisë

Ndikimi i vendeve të ndryshme ndaj Shqipërisë




Grafik 11. Ndikimi i vendeve të ndryshme ndaj Shqipërisë

Ndërkohë që lufta në Ukrainë ka hyrë në vitin e tretë, një tjetër konflikt i madh po formëson sigurisë ndërkombëtare, lufta Izrael-Gaza. Për të kuptuar pikëpamjet e qytetarëve shqiptarë për këto dy konflikte, u shtruan katër pyetje: “A duhet të mbështesë Shqipëria Ukrainën?”, “A duhet të mbështesë Shqipëria Izraelin?”, “A mendoni se vendet perëndimore duhet të përmirësojnë marrëdhëniet me Rusinë apo të vendosin më shumë sanksione?”, dhe “A mendoni se vendet perëndimore duhet të vendosin sanksione apo të mbështesin Izraelin për të fituar luftën në Gaza?”

Rezultatet tregojnë se qytetarët shqiptarë kanë pikëpamje shumë të ndryshme për pozicionin e Shqipërisë ndaj vendeve të përfshira. 83.5% e të anketuarve thonë se Shqipëria duhet të mbështesë Ukrainën, ndërsa 70.1% janë kundër mbështetjes së Shqipërisë për Izraelin. Megjithatë, krahasuar me vitin 2022, kur sapo kishte nisur lufta mes Rusisë dhe Ukrainës, ka një përqindje pak më të ulët të qytetarëve që janë në favor të mbështetjes së Shqipërisë ndaj Ukrainës.

A duhet ta mbështesë Shqipëria:




Grafik 12. Mbështetja e Shqipërisë për Ukrainën dhe Izraelin

Duke qenë se lufta në Ukrainë ka imponuar kosto të konsiderueshme, veçanërisht në ekonomi, përpjekja për të gjetur një zgjidhje duke konsideruar Rusinë është një zgjidhje alternative, e cila është mbështetur edhe nga fraksione të ndryshme politike në Perëndim. Pak më shumë se dy të tretat mendojnë se komuniteti perëndimor duhet të përpiqet të përmirësojë marrëdhëniet me Rusinë, megjithëse rreth dy të tretat mbështesin vendosjen e më shumë sanksioneve.

Një tendencë e ngjashme vërehet në përgjigjet e qytetarëve shqiptarë kur pyeten nëse komuniteti perëndimor duhet të vendosë sanksione ndaj Rusisë apo të përpiqet të përmirësojë marrëdhëniet. Krahasuar me vitin 2022, kur u shtrua e njëjta pyetje, ka një rritje prej 20 pikë përqindjeje që mbështesin vendosjen e më shumë sanksioneve ndaj Rusisë.

A mendoni se vendet Perëndimore duhet t'i përmirësojnë marrëdhëniet me Rusinë apo t'i vendosin asaj më shumë sanksione?



Grafik 13. Nëse vendet perëndimore duhet të përmirësojnë marrëdhëniet me Rusinë apo të vendosin më shumë sanksione

Sa i përket Izraelit, ka një ndarje më të qartë të opinionëve. 73.5% e të anketuarve mendojnë se vendet perëndimore duhet të vendosin sanksione ndaj Izraelit dhe 20.5% mendojnë se Perëndimi duhet të ofrojë mbështetje për të fituar luftën në Gaza.

A mendoni që vendet Perëndimore duhet të vendosin sanksione ndaj Izraelit apo ta mbështesin atë për të fituar luftën në Gazë?




Grafik 14. Nëse vendet perëndimore duhet të vendosin sanksione apo të mbështesin Izraelin për të fituar luftën në Gaza

Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës mbetet një çështje kyçe për sigurinë e Ballkanit dhe më gjerë të Evropës, pasi ka përpjekje të shtuara të Rusisë për të krijuar një konflikt në rajon dhe për të larguar vëmendjen nga lufta në Ukrainë. Marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë nga ana tjetër janë formësuar nga marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Sondazhi

u përpoq të kapte opinionin e mbi marrëdhëniet komplekse të sigurisë në rajon duke bërë pyetje se si Shqipëria duhet t'i qaset të dyja vendeve.


Lidhur me marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë janë bërë dy pyetje: “A mendoni se Shqipëria dhe Kosova duhet të bashkërendojnë dhe unifikojnë politikën e tyre të jashtme?” dhe “A e përkrahni bashkimin e Shqipërisë me Kosovën?”. Shumica e të anketuarve, 84.8% janë pro bashkërendimit dhe unifikimit të politikës së jashtme ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Megjithatë, një përqindje më e vogël e qytetarëve, 70.5%, mbështesin bashkimin e dy vendeve.



Grafik 15. Natyra e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës

Përqindja më e madhe e qytetarëve shqiptarë, 79.8% mendojnë se Serbia është një kërcënim për sigurinë e Shqipërisë dhe një përqindje më e vogël prej 17.6% mendojnë kështu për Greqinë. Megjithatë, krahasuar me anketat e mëparshme ka një përqindje në rritje të qytetarëve që e konsiderojnë Greqinë si një kërcënim. Asnjë nga vendet e tjera të Ballkanit nuk shihet si një kërcënim për sigurinë e Shqipërisë.


Cilin nga vendet e Ballkanit Perëndimor e shihni si kërcënim për sigurinë e Shqipërisë?



Grafik 16. Vendet e Ballkanit që shihen si kërcënim për sigurinë e Shqipërisë

Megjithatë, pavarësisht se perceptohet si kërcënim për sigurinë, rreth dy të tretat e shqiptarëve (62.2%) mendojnë se Shqipëria dhe Serbia duhet të kenë një bashkëpunim më të madh mes tyre.


A jeni dakord që Shqipëria dhe Serbia të kenë bashkëpunim më të madh mes tyre?



Grafik 17. Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Serbisë

Shumica e shqiptarëve janë optimistë edhe për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Tre të pestat (60.2%) mendojnë se të dy vendet do të arrijnë një marrëveshje përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve brenda dy

vjetësh ose rreth kësaj kohe, ndërsa 37.5% mendojnë se kjo nuk do të ndodhë kurrë.



Grafik 18. Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi

Siguria politike

Për të fituar njohuri se sa të sigurtë ndihen shqiptarët politikisht, u bënë gjashtëmbëdhjetë pyetje në lidhje me përfaqësimin e qytetarëve nga institucionet politike, llogaridhënien demokratike dhe fuqizimin politik të qytetarëve.

Në lidhje me masën në të cilën të anketuarit ndihen të përfaqësuar nga institucionet kryesore politike të vendit janë bërë pyetjet e mëposhtme: “A ndiheni të përfaqësuar nga parlamenti?”, “A ndiheni të përfaqësuar nga qeveria në nivel qendror (qeveria dhe ministrinë)”, “A ndiheni të përfaqësuar nga institucionet e qeverisjes vendore (bashkia/prefektura)”.

Rezultatet tregojnë se shumica e shqiptarëve nuk ndjehen të përfaqësuar nga institucionet e tyre demokratike. Vetëm 8.3% thonë se ndjehen të përfaqësuar nga parlamenti, 11% thonë kështu për pushtetin qendror dhe 16% për institucionet e qeverisjes vendore.


Duke qenë se parlamenti është institucioni më i rëndësishëm në vend për sa i përket përfaqësimit politik, fakti që 41.7% e qytetarëve thonë se nuk ndjehen të përfaqësuar nga parlamenti, paraqet një burim të rëndësishëm pasigurie politike.

Përgjegjësia demokratike i referohet mënyrave të shumta nëpërmjet të cilat qytetarët, partitë politike, parlamentet dhe aktorët e tjerë demokratikë mund të ofrojnë reagime, të shpërblejnë ose të sanksionojnë zyrtarët e ngarkuar me përcaktimin dhe zbatimin e politikave publike.

Për të marrë opinionin e qytetarëve për llogaridhënien demokratike, u bënë pyetjet e mëposhtme: “A mendoni se parlamentarët dhe qeveria (kryeministri dhe ministrat) janë të shqetësuar për të zbatuar vullnetin e votuesve?”, “Sa shpesh mendoni se liderët e qeverisë thyjnë ligj apo shpërdorojnë pushtetin e tyre?”, “Sa shpesh mbeten të pandëshkuar zyrtarët që kryejnë krime?”, “A është parlamenti në gjendje të mbajë nën kontroll ekzekutivin/qeverinë?”, “A mendoni se zgjedhjet në Shqipëri ofrojnë një zgjedhje reale të alternativave politike për qytetarët/votuesit?”.


Edhe pse 58.2% nuk kanë dhënë një përgjigje me po ose jo nëse deputetët, kryeministri dhe ministrat janë të shqetësuar për zbatimin e vullnetit të votuesve, vetëm një përqindje shumë e vogël prej 7.8% e qytetarëve thonë se e bëjnë këtë, ndërsa një e treta (33.9%) thonë jo.

A ndiheni të përfaqësuar nga:



Grafik 19. Përfaqësimi politik


A mendoni se parlamentarët dhe Qeveria (kryeministri dhe ministra) janë të interesuar për të zbatuar vullnetin e votuesve?



Grafik 20. Zbatimi i vullnetit të votuesve nga përfaqësuesit politikë


Shumica prej 82% e qytetarëve mendojnë se drejtuesit e qeverisë shkelin ligjin ose abuzojnë me pushtetin e dhënë gjithmonë ose shumicën e kohës. 71.6% mendojnë se krimet e kryera nga zyrtarët e qeverisë mbeten të pandëshkuara gjithmonë ose në shumicën e kohës.

Sa shpesh mendoni se udhëheqësit qeveritarë shkelin ligjin ose abuzojnë me pushtetin e dhënë?



Grafik 21. Sa shpesh drejtuesit e qeverisë shkelin ligjin ose abuzojnë me pushtetin e tyre


Sa shpesh mendoni se ata zyrtarë qeveritarë që kryejnë krime mbeten pa u ndëshkuar?



Grafik 22. Llogaridhënia e zyrtarëve të qeverisë që kryejnë krime

Pavarësisht rolit të tij qendror në sistemin e kontrollit dhe balancimit demokratik, parlamenti konsiderohet i paaftë për ta kryer këtë rol nga shumica e qytetarëve. 41,7% mendojnë se parlamenti nuk është në gjendje të mbajë nën kontroll ekzekutivin dhe 41,9% të tjerë mendojnë se është deri diku i aftë. Vetëm një përqindje e vogël prej 1.3% mendojnë se parlamenti është shumë i aftë dhe 14% të tjerë se po e mban qeverinë nën kontroll dhe llogaridhënie.

A mendoni se parlamenti është në gjendje ta mbajë qeverinë nën kontroll?




Grafik 23. Aftësia e parlamentit për ta mbajtur ekzekutivin përgjegjës

Përsa i përket pyetjes nëse zgjedhjet në Shqipëri ofrojnë një zgjedhje reale të alternativave politike dhe ndryshimit për votuesit shqiptarë, vetëm 10.9% thonë

se zgjedhjet gjithmonë ofrojnë një zgjedhje reale të alternativave politike dhe 30.3% të tjerë mendojnë se zgjedhjet e bëjnë këtë në shumicën e kohës. Shumica prej 58.4% e të anketuarve mendojnë se rrallë ose kurrë zgjedhjet në Shqipëri ofrojnë një zgjedhje reale të alternativave politike.


A mendoni se votuesit në Shqipëri kanë mundësi reale për të zgjedhur alternativën politike që dëshirojnë?



Grafik 24. Zgjedhja e alternativave politike në zgjedhje

Përafërsisht 38.5% e të anketuarve thonë se qytetarët nuk kanë ndikim në atë që bën qeveria dhe 34.7% të tjerë thonë se anojnë të pajtohen me këtë deklaratë. Nga ana tjetër, 45.7% mendojnë se pronarët e bizneseve të mëdha kanë një ndikim mbi atë që bën qeveria. Vetëm 7.1% mendojnë se qytetarët kanë ndikim në atë që bën qeveria dhe 19.3% anojnë të mendojnë kështu.


A kanë qytetarët e thjeshtë shqiptarë apo pronarët e bizneseve të mëdha ndonjë ndikim në atë që bën qeveria?



Grafik 25. Ndikimi në vendimet e qeverisë nga qytetarët e thjeshtë shqiptarë dhe nga pronarët e bizneseve të mëdha

Të anketuarit janë disi të ndarë kur pyeten për lirinë e tyre për të shprehur pa frikë kritikak e tyre për qeverinë apo pikëpamjet politike, ndonëse një përqindje e rëndësishme prej 38.9% thonë se nuk ndjehen të lirë të kritikojnë hapur qeverinë. Vetëm 25.8% thonë se mund të shprehin hapur kritikak e tyre dhe 35.1% prirën ta bëjnë këtë.


A janë njerëzit në Shqipëri të lirë të shprehin hapur dhe pa frikë kritikak e tyre për qeverinë apo pikëpamjet politike?



Grafik 26. Liria e qytetarëve shqiptarë për të shprehur hapur pa frikë kritikak e tyre për qeverinë apo pikëpamjet politike

Përgjigjet janë shumë të ndryshme kur qytetarët pyeten për lirinë e zyrtarëve të administratës publike për të shprehur pa frikë pikëpamjet e tyre politike. Shumica prej 39.8% thonë jo dhe 34.6% anojnë të mendojnë kështu. Vetëm 7.3% thonë me siguri se ndjehen të lirë ta bëjnë këtë.


A mendoni se zyrtarët e administratës publike mund t'i shprehin pa frikë pikëpamjet e tyre politike?



Grafik 27. Liria e zyrtarëve të administratës publike për të shprehur pa frikë pikëpamjet e tyre politike

Qytetarët janë gjithashtu të ndarë kur pyeten për lirinë e medias për të kritikuar qeverinë pa frikë nga hakmarrja apo pasoja negative nga autoritetet qeveritare. Vetëm 15.9% thonë me siguri të plotë se media mund ta bëjë këtë, 33.8% të tjerë anojnë drejt këtij opsioni, ndërsa gati 50% nuk pajtohen ose piren të mos pajtohen.


A janë mediat të lira të kritikojnë qeverinë pa frikë nga ndonjë hakmarrje/kundërpërgjigje negative prej autoriteteve qeveritare?



Grafik 28. Liria e medias për të kritikuar qeverinë pa frikë nga hakmarrja prej autoriteteve qeveritare

Kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në protesta dhe demonstrata pa frikë nga ndonjë hakmarrje nga autoritetet qeveritare, shumica prej 59% mendojnë ose anojnë të mendojnë se mund ta bëjnë këtë. Megjithatë, një përqindje e konsiderueshme prej 40.7% kanë ose anojnë të kenë frikë nga pjesëmarrja në protesta dhe demonstrata.


A mund të marrin pjesë qytetarët në Shqipëri në protesta dhe demonstrata pa frikën e ndonjë hakmarrjeje nga autoritetet qeveritare?



Grafik 29. Liria e qytetarëve për të marrë pjesë në protesta dhe demonstrata pa frikën e ndonjë hakmarrjeje nga autoritetet qeveritare

Megjithatë, përgjigjet tregojnë se pak më shumë se gjysma e qytetarëve shqiptarë ndihen të pafuqishëm për të ndryshuar me mjete demokratike një qeveri që nuk u pëlqen. 50.7% mendojnë ose anojnë të mendojnë se nuk kanë një pushtet të tillë, ndërsa 48.6% mendojnë ose anojnë të mendojnë se kanë fuqinë për të ndryshuar me mjete demokratike një qeveri që nuk i pëlqen. Një përqindje më e madhe prej 26.8% dhanë një përgjigje të qartë jo, kundrejt 21.6% që thanë po.


A kanë fuqi qytetarët në Shqipëri ta ndryshojnë me mjete demokratike një qeveri që nuk e pëlqejnë?



Grafik 30. Fuqia e qytetarëve për të ndryshuar një qeveri që nuk u pëlqen me mjete demokratike

Të anketuarit janë pothuajse njëloj të ndarë nëse zgjedhjet do të jenë të lira dhe të ndershme. 49.1% mendojnë ose anojnë të mendojnë se zgjedhjet e vitit 2025 do të jenë të lira dhe të ndershme dhe 48.7% e tjerë mendojnë se zgjedhjet nuk do të jenë të lira dhe të ndershme. Megjithatë, më shumë qytetarë, 22.9%, kanë një mendim të qartë se zgjedhjet nuk do të jenë të lira dhe të ndershme kundrejt 17.4% që mendojnë të kundërtën.


A mendoni se zgjedhjet e përgjithshme të ardhshme (në vitin 2025) do të jenë të lira dhe të ndershme?



Grafik 31. Nëse zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025 do të jenë të lira dhe të ndershme

Duke pasur parasysh rëndësinë e shtuar të fesë në politikë, sondazhi synoi të merrte edhe opinionin e qytetarëve shqiptarë nëse komunitetet fetare duhet të konsultohen gjatë miratimit të ligjeve (“A mendoni se autoritetet qeveritare duhet të konsultohen me komunitetet fetare kur miratojnë ligjet?”). 31.8% e qytetarëve mendojnë se komunitetet fetare duhet të konsultohen dhe 28.9% të tjerë thonë se anojnë të mendojnë kështu. Rreth një e treta, 37.9%, thonë se janë kundër ose anojnë të jenë kundër përfshirjes së komuniteteve fetare në politikëbërje. Kjo prirje mund të ndërlidhet me mungesën e perceptuar të pushtetit për të ndikuar në politikë dhe kompensimin e një mungese të tillë pushteti duke u mbështetur tek komunitetet fetare.

A mendoni se autoritetet qeveritare duhet të konsultohen me komunitetet fetare para se të miratojnë ligje?



Grafik 32. Nëse bashkësitë fetare duhet të konsultohen nga institucionet gjatë miratimit të ligjeve


Siguria ekonomike

Për të marrë njohuri mbi opinionet për sigurinë ekonomike, të anketuarve iu drejtuan pyetje në lidhje me sigurinë dhe stabilitetin e perceptuar të të ardhurave të tyre personale dhe familjare në të tashmen dhe në një të ardhme të parashikuar prej tyre, sigurinë e tyre për akses në punësim në të tashmen dhe në të ardhmen dhe opinionin e tyre për gjendjen e ekonomisë shqiptare. Në total, 20 pyetje iu dedikuan sigurisë ekonomike.

Grupi i mëposhtëm prej shtatë pyetjesh fokusohet në marrjen e ndjenjës së sigurisë në drejtim të të ardhurave personale dhe të familjes: “Si do ta gjykoni situatën aktuale financiare të shtëpisë/familjes suaj?”, “Si prisni të jenë financat e familjes suaj në 1 deri 2 vitet e ardhshme, krahasuar me sot?”, “Gjendja financiare e shtëpisë/familjes suaj është më e mirë apo më e keqe se 12 muaj më parë?”, “Në 3-5 vitet e ardhshme, a mendoni se gjendja financiare e shtëpisë/familjes suaj do të jetë më e mirë apo më keqe se sot?”, “Sa i shqetësuar jeni që në 3-5 vitet e ardhshme nuk do të jeni aq të sigurtë financiarisht?”, “Sa i shqetësuar jeni që në moshë të avancuar mund të mos jeni financiarisht të sigurt?”, “Sa jeni të shqetësuar që mund të mos jeni në gjendje të gjeni një banesë të përshtatshme apo të mbani atë që keni?”.


Për sa i përket situatës financiare aktuale, të anketuarit janë mjaft të ndarë. 35.7% mendojnë se situata financiare aktuale e familjes së tyre është e mirë ose shumë e mirë, ndërsa 22.4% mendojnë se është e keqe ose shumë e keqe. 42% mendojnë se nuk është as e mirë as e keqe.

Dallime evidentohen për sa i përket nivelit të arsimimit. 36.3% e të anketuarve me arsim universitar mendojnë se situata financiare aktuale e familjes së tyre është e mirë ose shumë e mirë kundrejt 20.7% të atyre pa arsim universitar që mendojnë të njëjtën gjë.




Grafik 33. Situata financiare aktuale në familje

64.2% shprehen se kanë të njëjtën situatë financiare si një vit më parë. Për 19.3%, situata financiare është përmirësuar, ndërsa për 16.5%, ajo është përkeqësuar. Arsimi është sërish një faktor parashikues, pasi 28.3% e të anketuarve me arsim universitar raportojnë një situatë më të mirë financiare se një vit më parë, kundrejt 14.9% të atyre pa arsim universitar.



Grafik 34. Situata financiare e shtëpisë/familjes krahasuar me 12 muaj më parë


Për sa i përket pritshmërive për të ardhmen e afërt, gjysma e të anketuarve thonë se presin që situata financiare e familjes të mbetet e njëjtë në një deri në dy vitet e ardhshme. 36.3% presin që ajo të përmirësohet dhe 12.1% thonë se do të jetë më keq.



Grafik 35. Pritshmëritë për situatën financiare të familjes në 1 deri në 2 vitet e ardhshme

Një tendencë e ngjashme vërehet kur u kërkohet të japin pritshmëritë e tyre për situatën financiare në tre deri pesë vitet e ardhshme, por një përqindje pak më e lartë, 42%, presin një situatë më të mirë financiare. 12.9% e të anketuarve të moshës 50 vjeç e lart presin një situatë më të keqe, kundrejt 8.4% të atyre të moshës 18-49 vjeç. Një tendencë e ngjashme vërehet në përgjigjet sipas nivelit të arsimit: një përqindje më e lartë e atyre me arsim universitar thonë se presin një situatë më të mirë financiare.


Në 3-5 vitet e ardhshme, mendoni se situata financiare e shtëpisë/familjes suaj do të jetë më e mirë apo më e keqe se ç'është sot?



Grafik 36. Situata financiare e shtëpisë/familjes në 3-5 vitet e ardhshme

Në nivel personal, ka një nivel më të lartë shqetësimi sesa në nivel familjar. Të anketuarit janë pothuajse njëlloj të ndarë mes atyre që thonë se nuk shqetësohen se mund të mos jenë aq të sigurt financiarisht në tre deri pesë vitet e ardhshme (34.7%), atyre që thonë se janë shumë të shqetësuar (31.4%) dhe atyre që janë deri diku të shqetësuar (33.4%). Edhe për këtë pyetje, përqindja e atyre me arsim universitar që shprehin shqetësim është më e vogël se e atyre me arsim më të ulët.


Sa i/e shqetësuar jeni se në 3-5 vitet e ardhshme mund të mos jeni aq i/e sigurt financiarisht?



Grafik 37. Siguria financiare personale në 3-5 vitet e ardhshme

Një nivel më i lartë i pasigurisë vërehet kur të anketuarit pyeten për ndjenjën e tyre të sigurisë financiare në moshë të avancuar. Vetëm një e katërta e të anketuarve thonë se nuk janë aspak ose nuk janë shumë të shqetësuar, ndërsa 37.4% thonë se janë shumë të shqetësuar.

Sa i/e shqetësuar jeni se në moshë të avancuar mund të mos jeni financiarisht i/e sigurt?




Grafik 38. Siguria financiare personale në moshë të avancuar

Tendenca është e ndryshme në parashikimin për strehimin. Shumica prej 59.5% thonë se nuk shqetësohen fare ose nuk shqetësohen shumë për gjetjen e një banese të përshtatshme apo për të mbajtur atë që kanë.

Megjithatë, pasiguria mbetet e lartë për një përqindje të rëndësishme të qytetarëve të anketuar. 15.5% shprehen se janë shumë të shqetësuar dhe 24.7% janë deri diku të shqetësuar. Përqindja e të anketuarve të moshës 18-

49 vjeç që thonë se janë shumë të shqetësuar ose deri diku të shqetësuar është më e lartë se ajo e atyre mbi 50 vjeç.




Grafik 39. Shqetësimet për të gjetur një banesë të përshtatshme

Krahas pyetjes për sigurinë financiare personale, qytetarët u pyetën për pikëpamjet e tyre për ekonominë e vendit, cilësinë e jetës në vend dhe për rolin e qeverisë në mirëqenien dhe sigurinë e tyre.

9 pyetje u përpoqën të merrnin njohuri mbi këto çështje: “Cili është mendimi juaj për gjendjen aktuale të ekonomisë shqiptare?”, “A është situata aktuale ekonomike e vendit tonë më e mirë apo më e keqe se 12 muaj më parë?”, “Si do ta gjykoni situatën aktuale të cilësisë së jetës në Shqipëri?”, “Cilat janë pritshmëritë tuaja për cilësinë e jetës në Shqipëri në 1 deri në 2 vitet e ardhshme?”, “A ofron qeveria mbështetjen e duhur për të papunët?”, “Si rezultat i politikave të qeverisë në 5 vitet e fundit, a mendoni se hendeku midis të pasurve dhe të varfërve është ngushtuar apo është zgjeruar?”, “Në rast se ju ose shtëpia/familja juaj do të përjetonit probleme financiare, sa të sigurt jeni që përfitimet dhe shërbimet e ofruara nga qeveria do t’ju mbështesin mjaftueshëm gjatë vështirësive financiare?”, “Në rast se ju ose shtëpia/familja juaj do të përjetonit probleme financiare, sa i sigurt jeni se një mik ose anëtar i familjes do të jetë në gjendje dhe i gatshëm t’ju ndihmojë? ”, “A i merr qeveria parasysh pikëpamjet e njerëzve si ju kur harton apo reformon politikatat ekonomike?”.

40.5% e të anketuarve mendojnë se gjendja aktuale e ekonomisë shqiptare është e keqe ose shumë e keqe dhe 42.5% mendojnë se nuk është as e keqe as e mirë. Vetëm 15.1% mendojnë se gjendja ekonomike e vendit është e mirë ose shumë e mirë.


Cili është opinioni juaj për gjendjen aktuale të ekonomisë shqiptare?



Grafik 40. Gjendja aktuale e ekonomisë shqiptare

Krahasuar me një vit më parë, rreth gjysma e të anketuarve (52.5%) mendojnë se situata aktuale ekonomike e vendit është e njëjtë, 19.7% mendojnë se është përmirësuar ndërsa 27.6% mendojnë se është përkeqësuar.

Si mendoni, situata ekonomike e vendit tonë është më e mirë apo më e keqe se para 12 muajve?




Grafik 41. Situata e ekonomisë shqiptare krahasuar me një vit më parë

38.9% thonë se situata aktuale e cilësisë së jetës në Shqipëri nuk është as e mirë dhe as e keqe, ndërsa për 35.2% është e keqe ose shumë e keqe. Vetëm rreth një e katërta thonë se situata aktuale e cilësisë së jetës në Shqipëri është e mirë dhe një fraksion shumë i vogël prej 0.8% thonë se është shumë e mirë.

Ndryshime konstatohen në përgjigjet e të anketuarve për sa i përket nivelit të arsimimit. 11.6% e të anketuarve që kanë mbaruar arsimin universitar thonë se

cilësia e jetës është e keqe, ndërsa 22.2% e atyre pa arsim universitar thonë të njëjtën gjë.


Si e vlerësoni aktualisht cilësinë e jetës në Shqipëri?



Grafik 42. Situata aktuale e cilësisë së jetës në Shqipëri

Megjithatë, pritshmëria e përgjithshme për një ose dy vitet e ardhshme është mjaft optimiste. Vetëm 16.8% thonë se presin që cilësia e jetës të jetë më e keqe dhe më shumë se dyfishi i kësaj shifre pret të jetë më e mirë. 46.2% presin të njëjtën cilësi jetese. Përsëri, ka një përqindje më të lartë të atyre me arsim universitar që presin një cilësi jetese më të mirë në një ose dy vitet e ardhshme (45.4% e të anketuarve që kanë përfunduar arsimin universitar kundrejt 31.8% të atyre pa arsim universitar). Ndryshime vërehen edhe mes grupmoshave. 42.1% e moshave 18-49 thonë se presin një situatë më të mirë financiare kundrejt 29.2% të atyre mbi 50 vjeç.


Cilat janë pritshmëritë tuaja për cilësinë e jetës në Shqipëri në 1 deri 2 vitet e ardhshme, krahasuar me sot?



Grafik 43. Cilësia e jetës në Shqipëri në 1 deri 2 vitet e ardhshme

Për shumicën dërrmuese të të anketuarve, qeveria nuk ofron mbështetje të mjaftueshme për personat e papunë. Vetëm 15.6% thonë se qeveria ofron mbështetje të mjaftueshme për të papunët. Për shumicën prej 51.6% qeveria nuk ofron mbështetje të mjaftueshme për të papunët dhe 32% e tjerë thonë se anojnë të mendojnë se një mbështetje e tillë nuk është e mjaftueshme.

A ofron qeveria mbështetje të mjaftueshme për personat e papunë?




Grafik 44. Mbështetja e qeverisë për personat e papunë

Rezultatet tregojnë një tendencë të ngjashme në lidhje me mjaftueshmërinë e mbështetjes nga qeveria në rast të vështirësive të mëdha financiare. 38.7% thonë se nuk kanë besim se qeveria do t'u ofrojë mbështetje të mjaftueshme nëse përballen me vështirësi financiare. 28.9% thonë se kanë pak besim, ndërsa 23.8% thonë se besojnë deri diku se një mbështetje e tillë nga qeveria do tu ofrohet mjaftueshëm.

Të anketuarit shfaqën më shumë besim te miqtë dhe të afërmit për të tejkalluar vështirësitë financiare të mundshme. 21.6% thonë se kanë shumë besim se miqtë dhe të afërmit do t'i mbështesin, 38.5% besojnë deri diku, ndërsa 39.8% mendojnë se nuk do të marrin shumë ose asnjë mbështetje financiare të nevojshme.

Në rast se ju apo familja juaj do të përjetoni vështirësi financiare për shkaqe fatkeqësie natyrore, apo shkaqe të tjera madhore, sa besim keni se qeveria do t'ju mbështesë apo një mik ose anëtar i familjes t'ju ndihmonte për kapërcimin e vështirësive?




Grafik 45. Mbështetjen nga qeveria dhe të afërmit në rast nevoje

Të anketuarve iu kërkua gjithashtu t'u përgjigjen pyetjeve mbi rolin e qeverisë në politikat e shpërndarjes dhe nëse qeveria merr parasysh pritshmëritë e qytetarëve gjatë hartimit të politikave ekonomike. Për këtë qëllim u shtruan pyetjet e mëposhtme: “Si rezultat i politikave të qeverisë në 5 vitet e fundit, a mendoni se hendeku midis të pasurve dhe të varfërve është bërë më i NGUSHTË apo më i GJERË?”, “A merr parasysh qeveria pikëpamjet e njerëzve si ju kur harton apo reformon politikat ekonomike?”.

Shumica prej 41.3% e të anketuarve thonë se politikat e qeverisë në 5 vitet e fundit kanë kontribuar në zgjerimin e hendekut mes të pasurve dhe të varfërve dhe 40% thonë se ky hendek mund të jetë bërë edhe më i madh. 17.7% thonë se hendeku midis të pasurve dhe të varfërve në vend është bërë më ngushtë.


Si rezultat i politikave qeveritare në 5 vitet e fundit, mendoni se hendeku mes të pasurve dhe të varfërve është bërë më i gjerë apo më i ngushtë?



Grafik 46. Hendeku midis të pasurve dhe të varfërve në vend

42.3% e të anketuarve mendojnë se qeveria nuk i merr parasysh pikëpamjet e qytetarëve të thjeshtë kur harton apo reformon politikat ekonomike dhe 33,4% të tjerë anojnë të mendojnë kështu. 18.3% thonë se anojnë të pajtohen se pikëpamjet e qytetarëve të thjeshtë merren parasysh dhe vetëm 5.2% janë plotësisht dakord.


A i merr parasysh qeveria nevojat dhe pikëpamjet e qytetarëve të thjeshtë si ju, kur formulon apo ndryshon politikat ekonomike?



Grafik 47. Konsideratat e qeverisë për pikëpamjet e qytetarëve mbi politikat ekonomike

Qytetarëve iu kërkua të japin mendimin e tyre nëse vlerësojnë më shumë zhvillimin ekonomik apo demokracinë dhe se cilët sektorët të ekonomisë ata


mendojnë se janë më të rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Për këtë qëllim u shtruan pyetjet e mëposhtme: "Nëse do t'ju duhej të zgjidhnit midis demokracisë dhe zhvillimit ekonomik, cila do të thoshit se është më e rëndësishme?" dhe "Cili sektor mendoni se është më i rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë?". 56.2% zgjedhën zhvillimin ekonomik dhe 14.2% thanë se ndoshta do të zgjidhnin zhvillimin ekonomik. 29.2% thanë se do të zgjidhnin me siguri demokracinë ose ndoshta demokracinë në vend të zhvillimit ekonomik.



Grafik 48. Zgjedhja midis demokracisë dhe zhvillimit ekonomik

Turizmi është më i rëndësishëm se sektorët e tjerë për zhvillimin ekonomik të vendit sipas 40.2% të të anketuarve, ndërsa për 36.7% bujqësia është më e rëndësishme. 17.3% e qytetarëve mendojnë se industria nxjerrëse (nafta dhe minerale) është më e rëndësishme për ekonominë dhe 5.6% teknologjia e informacionit. Vërehen dallime për sa i përket vendbanimit dhe nivelit të arsimit. Në zonat rurale ose rrethinat, 45.4% dhe 33.2% e banorëve besojnë se bujqësia dhe turizmi, respektivisht, janë më të rëndësishme, krahasuar me 29.6% dhe 46.0% të atyre që jetojnë në qytet. Në lidhje me nivelin e arsimit, 47% e atyre me arsim universitar shprehin se turizmi është më i rëndësishëm, ndërsa ky numër është 36.5% për të anketuarit pa arsim universitar.

Cili sektor mendoni se është më i rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë?




Grafik 49. Sektorët më të rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë

Një grup prej tetë pyetjesh në lidhje me sigurinë ekonomike u shtruan për të marrë qëndrimet dhe opinionet e qytetarëve për aksesin në punë dhe mbajtjen e punës, përshtatshmërinë e kushteve të punës dhe pagesave në sektorin privat, opinionin mbi politikën e qeverisë për punësimin, si dhe perspektivën e gjetjes së një pune jashtë vendit.

“Sa e lehtë është të gjejsh një punë në Shqipëri?”, “A është më e lehtë për gratë apo për burrat të gjejnë një punë në Shqipëri?”, “Sa ka gjasa që ju (ose personi me të ardhurat më të larta në familjen tuaj) të humbni punën apo të ardhurat nga vetëpunësimi në 12 muajt e ardhshëm?”, “Sa jeni të shqetësuar për të mos pasur aftësitë dhe njohuritë e duhura për të punuar në një punë të qëndrueshme dhe të mirëpaguar?”, “A mendoni se punëdhënësit privatë ofrojnë pagesa të përshtatshme/të denja në Shqipëri?”, “A ofrojnë punëdhënësit privatë kushte të mira pune në Shqipëri?”, “A mendoni se qeveria shqiptare ka bërë përpjekjet e duhura për të krijuar vende pune për të gjithë?”, “A mendoni se shqiptarët duhet të bëjnë përpjekje për të gjetur punë dhe punuar në Shqipëri apo të kërkojnë punë jashtë vendit?”.

67.4% e të anketuarve thonë se gjetja e një pune në Shqipëri nuk është e lehtë ose aspak e lehtë. Rreth një e treta (31.7%) thonë se është relativisht e lehtë ose shumë e lehtë.


Sa e lehtë është që të gjejsh një punë në Shqipëri?



Grafik 50. Lehtësia e gjetjes së një pune në Shqipëri

Sa i përket gjetjes të punës nga femrat apo meshkujt, gjysma e të anketuarve (49%) thonë se është e njëjtë për të dyja gjinitë, ndërsa 30.9% mendojnë se është më e lehtë për meshkujt dhe 19.4% për femrat.


A është më e lehtë për gratë apo për burrat të gjejnë një punë në Shqipëri?



Grafik 51. Lehtësia e gjetjes së një pune në Shqipëri në bazë të gjinisë

Shumica, 56.1%, thonë se nuk janë të shqetësuar se aftësitë dhe njohuritë do të jenë një problem për ta për të pasur ose mbajtur një punë. Megjithatë, një përqindje e rëndësishme, 40.8%, thonë të kundërtën, përfshirë 13.3% që shprehen se janë shumë të shqetësuar.


Sa i/e shqetësuar jeni se mos nuk keni aftësitë dhe njohuritë e duhura për të punuar në një profesion të qëndrueshëm dhe me pagesë të mirë?



Grafik 52. Përshtatshmëria e aftësive për të gjetur ose mbajtur një punë

Përsa i përket perspektivës së mbajtjes së punës aktuale (si nga të punësuarit ashtu edhe nga të vetëpunësuarit), në vitin e ardhshëm, 43.4% shprehin se janë shumë ose disi të shqetësuar. 30.7% thonë se nuk janë aspak të shqetësuar dhe 23.1% se janë disi të shqetësuar. Përqindja e atyre që ndjehen të pasigurt është më e lartë tek ata pa arsim universitar. 47.8% prej tyre shprehin se janë shumë ose disi të shqetësuar, krahasuar me 34.5% të atyre që kanë arsim universitar dhe mendojnë në të njëjtën mënyrë.

Sa gjasa ka që personi me të ardhurat më të larta në familjen tuaj të humbasë vendin e punës ose të ardhurat nga vetëpunësimi në 12 muajt e ardhshëm?




Grafik 53. Siguria e mbajtjes së punës në vitin e ardhshëm

Sipas statistikave zyrtare të punësimit, në Shqipëri deri në fund të vitit 2023 janë punësuar 730,000 persona, nga të cilët 549,000 në sektorin privat dhe 181,000 në sektorin publik. Duke u nisur nga rëndësia e sektorit privat për nga madhësia e tregut të punës, qytetarët janë pyetur për përshtatshmërinë e pagesës dhe kushteve të punës të ofruara nga punëdhënësit privatë.

Në përgjithësi, një përqindje më e lartë e të anketuarve thonë se kushtet e punës janë të përshtatshme ose deri diku të përshtatshme, në krahasim me ato që thonë kështu për pagesën. Megjithatë, ka më shumë qytetarë që thonë se kushtet e punës janë të papërshtatshme ose disi të papërshtatshme.

Sa i përket pagesës, vetëm 6.3% thonë se pagat janë të përshtatshme dhe 23.8% anojnë të mendojnë kështu. 68.5% thonë se pagat janë të papërshtatshme ose anojnë të mendojnë kështu.


Sa i përket kushteve të punës, 7.5% thonë se janë të përshtatshme dhe 34.1% anojnë të mendojnë kështu. Nga ana tjetër, 24.3% thonë se kushtet janë të papërshtatshme dhe 32.5% anojnë të mendojnë kështu.



Grafik 54. Përshtatshmëria e kushteve të punës dhe pagesave në sektorin privat

Sa i përket roli të Qeverisë për krijimin e vendeve të punës, shumica dërrmuese thonë se përpjekjet e tilla janë të pamjaftueshme ose deri diku të pamjaftueshme. Vetëm 3.6% thonë se qeveria ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të krijuar vende pune në Shqipëri dhe 17.7% anojnë të mendojnë kështu.


A mendoni se qeveria Shqiptare ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të krijuar punë për të gjithë?



Grafik 55. Përpjekjet e Qeverisë për krijimin e vendeve të punës

Pavarësisht pakënaqësisë me pagesën dhe kushtet e punës në sektorin privat, si dhe pakënaqësisë me rolin e qeverisë në krijimin e vendeve të punës dhe trendin e përgjithshëm të largimit nga vendi, shumica, 61.3%, thonë se njerëzit duhet të bëjnë përpjekje për të gjetur punë dhe për të punuar në Shqipëri në vend që të shkojnë jashtë vendit. Një përqindje më e lartë, 65.8%, e atyre mbi 50 vjeç mendojnë kështu, krahasuar me 57.6% të atyre të moshës nga 18 deri në 49 vjeç.

A mendoni se shqiptarët duhet të bëjnë përpjekje për të gjetur punë dhe për të punuar në Shqipëri apo të kërkojnë punë jashtë vendit?



Grafik 56. Nëse njerëzit duhet të bëjnë përpjekje për të gjetur punë dhe punuar në Shqipëri apo të kërkojnë punë jashtë vendit


Siguria ushqimore

Sipas OKB-së, siguria ushqimore të thotë që njerëzit të kenë akses fizik dhe ekonomik në ushqimin bazë. Pyetjet u hartuan për të marrë informacion dhe mendim nga qytetarët për aksesin në ushqim në aspektin sasior dhe cilësor përmes një grupi prej gjashtë pyetjesh. “Në 12 muajt e fundit, a keni zvogëluar apo anashkaluar ndonjëherë ju dhe familja juaj sasinë e vakteve tuaja, sepse nuk kishit para të mjaftueshme për të blerë ushqim?”, “Në 12 muajt e fundit, a jeni shqetësuar ju dhe familja juaj që ushqimi do të mbaronte para se të merrnit para për ta blerë përsëri?”, “Në 12 muajt e fundit, a mund të përballonte familja juaj të blinte llojet e ushqimeve që dëshironit të hanit?”, “Në 12 muajt e ardhshëm, a jeni ju dhe familja juaj më pak apo jeni më të shqetësuar për plotësimin e nevojave tuaja ushqimore?”, “A mendoni se kontrollet e sigurisë ushqimore nga institucionet shtetërore janë të duhura?”, A mendoni se produktet ushqimore në tregjet e Shqipërisë janë të sigurta dhe të padëmshme për shëndetin?”.

Sa i përket aksesit në ushqim, shumica prej 63.5% e të anketuarve thonë se nuk kanë qenë të detyruar të zvogëlojnë sasinë e ushqimit për shkak të mungesës së aksesit ekonomik apo fizik. Për një të tretën e të anketuarve një akses i tillë ka qenë sfidë dhe 13.8% thonë se u është dashur të reduktojnë marrjen e ushqimit gjatë vitit të kaluar. 11.9% u është dashur ta bëjnë këtë për disa muaj dhe 10.6% të tjerë për një ose dy muaj.

Vërehen dallime në aspektin e aksesit në ushqim bazuar në nivelin arsimor të të anketuarve. Nga të anketuarit me arsim universitar, 20.3% thonë se janë përballur me sfida për të siguruar ushqim për familjet e tyre, ndërsa 44.3% e atyre pa arsim universitar janë përballur me sfida të tilla. Diferencë më e vogël vërehet mes grupmohave nga 50 vjeç e lart, 30.7% e të cilëve përgjigjen se janë përballur me sfida të tilla kundrejt 21.5% të moshës nga 18 deri në 49 vjeç.


Në 12 muajt e fundit, ju ose të rritur të tjerë në shtëpinë/familjen tuaj, a e keni zvogëluar ndonjëherë sasinë e ushqimit apo keni lënë vakt pa ngrënë, ngaqë nuk kishit mjaftueshëm para për ushqim?



Grafik 57. Aksesit në ushqim për familjet gjatë vitit të kaluar

Më shumë të anketuar shprehin shqetësimin në lidhje me sigurinë ekonomike për të pasur akses në ushqim në të ardhmen. 18.7% thonë se kanë qenë të shqetësuar çdo muaj se ushqimi do të mbaronte para se të merrnin pagesën e radhës për të blerë përsëri ushqime, ndërsa për 25.5% të tjerë ky shqetësim ishte për vetëm një ose dy muaj dhe për disa muaj. 55.5% raportuan se nuk e kishin patur fare një shqetësim të tillë. Në mënyrë të ngjashme, si me pyetjen për aksesin në ushqim, një përqindje më e lartë e atyre pa arsim universitar dhe mbi 50 vjeç thanë se ishin të shqetësuar për ushqimin në muajin/muajt e ardhshëm.

Në 12 muajt e fundit, ju dhe familja juaj a keni qenë të preokupuar se ushqimi do t'ju mbarojë para se të merrni pagesën e radhës për të blerë përsëri ushqime?



Grafik 58. Shqetësimi për aksesin në ushqim gjatë vitit të fundit

Sa i përket aksesit në llojet e ushqimeve të dëshiruara, 27.7% thonë se gjatë vitit të kaluar kanë pasur mundësi të blejnë gjithmonë ato ushqime që kanë dashur të konsumojnë, ndërsa 61.2% thonë se jo gjithmonë e kanë patur të mundur të blejnë llojet e ushqimeve që dëshironin. 11.2% raportuan se gjatë vitit të kaluar nuk kanë mundur asnjëherë të blejnë llojet e ushqimeve që dëshironin të kishin.


Në 12 muajt e fundit, a e kishte familja juaj mundësinë për të blerë llojet e ushqimit që dëshironit të konsumonit?



Grafik 59. Aksesin në llojet e ushqimeve të dëshiruara gjatë vitit të kaluar

Sa i përket perspektivës për vitin e ardhshëm, 56.6% shprehen se kanë të njëjtin shqetësim si gjatë vitit të kaluar për plotësimin e nevojave të tyre për ushqim, ndërsa 23.9% thonë se janë më shumë të shqetësuar.


Në 12 muajt e ardhshëm, ju dhe familja juaj do të jeni më pak apo më shumë të shqetësuar për plotësimin e nevojave ushqimore?



Grafik 60. Shqetësimet për plotësimin e nevojave ushqimore gjatë 12 muajve të ardhshëm

Përsa i përket sigurisë ushqimore, 43,1% shprehen se produktet ushqimore që shiten në tregjet shqiptare nuk janë të sigurta dhe 33,8% anojnë të mendojnë kështu. Vetëm 4.5% thonë se ushqimi i shitur në tregjet shqiptare është i sigurt dhe 18.6% anojnë të mendojnë kështu.


A mendoni se produktet ushqimore të shitura në Shqipëri janë të sigurta dhe të padëmshme për shëndetin?



Grafik 61. Siguria e ushqimeve të shitura në tregjet shqiptare

Rreth gjysma e të anketuarve (47.1%) mendojnë se kontrollet e sigurisë ushqimore nga institucionet shtetërore nuk janë të duhura dhe 32.8% të tjerë

anojnë të mendojnë kështu. Vetëm 5.5% thonë se kontrollet e sigurisë ushqimore nga institucionet shtetërore janë të duhura dhe 13.7% anojnë të mendojnë kështu.



Grafik 62. Kontrollet e sigurisë ushqimore nga institucionet shtetërore


Siguria shëndetësore

Dy grupe pyetjesh u përpiluan për të marrë informacion mbi opinionin e qytetarëve për sigurinë shëndetësore.

Një grup prej shtatë pyetjesh kishte si qëllim të merrte njohuri mbi opinionin e qytetarëve për aksesin dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore publike dhe për sigurinë e produkteve farmaceutike të shitura në Shqipëri: “Nga përvoja juaj në vitet e kaluara, kur ju ose një anëtar i familjes suaj kishit nevojë për kujdes spitalor, e keni marrë shërbimin në një spital publik apo privat?”, “Nga përvoja juaj në vitet e kaluara, kur ju ose një anëtar i familjes kishit nevojë për trajtim/shërbim mjekësor, sa e lehtë ishte aksesi në shërbimin publik?”, “Si i vlerësoni spitalet publike në zonën tuaj?”, “A mendoni se mjekët dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor në institucionet shëndetësore publike i trajtojnë pacientët me respekt dhe konsideratë?”, “Nëse do të merrnit një trajtim apo shërbim mjekësor në të ardhmen, zgjedhja juaj e parë do të ishte një spital publik apo privat?”, “Nëse sëmureni, mendoni se do të merrni trajtimin e duhur në shërbimin shëndetësor publik?”.

Gjatë vitit të kaluar, një shumicë prej 68.7% thanë se ata ose familjarët e tyre kanë marrë trajtim mjekësor në një spital publik dhe 20.2% të tjera në një spital privat. 11.1% thanë se nuk kishin patur nevojë për shërbime trajtimi spitalore.


Nga përvoja juaj në vitet e fundit, kur ju ose një anëtar i familjes suaj ka patur nevojë për kujdes spitalor, a keni marrë shërbimin në një spital publik apo privat?



Grafik 63. Informacion mbi marrjen e trajtimit mjekësor në një spital publik ose privat

Sa i përket aksesit në trajtimin e përgjithshëm mjekësor në institucionet mjekësore të shërbimit publik, vetëm 9.5% janë përgjigjur se ishte shumë e lehtë dhe 42.6% thonë se ishte relativisht e lehtë. 43.6% u përgjigjën se nuk ishte e lehtë, ose ishte e vështirë për të aksesuar shërbime të tilla.


Nga përvoja juaj në vitet e fundit, kur ju ose një anëtar i familjes suaj ka patur nevojë për trajtim shëndetësor/shërbim, a ka qënë e lehtë për ta ma marrë shërbimin publik?



Grafik 64. Informacion mbi lehtësinë e shërbimeve shëndetësore publike gjatë vitit të kaluar

Të anketuarit janë disi të ndarë për cilësinë e spitaleve publike në Shqipëri. 43.6% thonë se shërbimi është mesatar dhe 31.1% thonë se shërbimi është i mirë. Vetëm 1.7% mendojnë se cilësia është e shkëlqyer dhe 22.8% se cilësia është e keqe. Vërehen disa variacione në përgjigjet në bazë të zonës së banimit. Një përqindje më e lartë e qytetarëve që banojnë në zonat rurale dhe rrethina mendojnë se cilësia e shërbimit është e mirë (35.2%) krahasuar me qytetarët që banojnë në zonat urbane (27.7%).


Si i vlerësoni spitalet publike në zonën ku banoni?



Grafik 65. Cilësia e spitaleve publike

Sa i përket cilësisë së trajtimit nga personeli i institucioneve shëndetësore publike, 21.7% mendojnë se mjekët dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor në institucionet publike shëndetësore i trajtojnë pacientët me respekt dhe konsideratë gjatë gjithë kohës. 60.6% thonë se e bëjnë këtë ndonjëherë dhe 17.1% mendojnë se pacientët nuk trajtohen kurrë me respekt dhe konsideratë.


A mendoni se mjekët dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor në institucionet shëndetësore publike i trajtojnë pacientët me respekt dhe kujdes?



Grafik 66. Trajtimi nga ofruesit e kujdesit shëndetësor në institucionet publike shëndetësore

Spitalet publike do të zgjidheshin nga 65.6% e të anketuarve për të marrë trajtimin mjekësor në të ardhmen. 34% thonë se do të zgjidhnin një spital privat.


Nëse do të keni nevojë për trajtim ose shërbim mjekësor në të ardhmen, zgjedhja juaj e parë, nisur nga mundësia financiare do të ishte një spital publik apo privat?



Grafik 67. Zgjedhja e parë për të marrë trajtim mjekësor

Megjithatë, vetëm 9,6% mendojnë se do të merrnin një trajtim të kënaqshëm në shërbimin shëndetësor publik, ndërsa 44,2% të tjerë anojnë të mendojnë kështu. 14.5% thonë se nuk mendojnë se do të merrnin një trajtim të kënaqshëm në një shërbim shëndetësor publik dhe 31.2% anojnë të mendojnë kështu.


Nëse sëmureni, a mendoni se do të merrni një trajtim të kënaqshëm në shërbimin shëndetësor publik?



Grafik 68. Kënaqshmëria e trajtimit nga shërbimet shëndetësore publike

Përsa i përket sigurisë së produkteve farmaceutike që shiten në vend, 36,1% e të anketuarve mendojnë se ilaçet që shiten në Shqipëri nuk janë të sigurta dhe mund të jenë të dëmshme për shëndetin, ndërsa 33,3% e tjerë anojnë të mendojnë kështu. Vetëm 8.2% janë përgjigjur me besim se medikamentet/ilaçet që shiten në Shqipëri janë të sigurta dhe 21.6% të tjerë anojnë të mendojnë kështu.

A besoni se medikamentet/ilaçet që shiten në Shqipëri janë të sigurta dhe të padëmshme për shëndetin?




Grafik 69. Siguria e medikamenteve/ilaçeve që shiten në Shqipëri

Një grup tjetër prej pesë pyetjesh pati si qëllim të merrte opinionin e qytetarëve mbi përballueshmërinë ekonomike të shërbimeve mjekësore.

